



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE

Nr. 8295

Tirane, date 15.12/2015

Drejtuar: ZOTIT LULËZIM SULOLLARI
SHOQERIA "O.L.I.A" SHPK
LAGJIA NR.2, LIBRAZHD

ELBASAN

Për njoftim: Z. VIKTOR DODA, DREJTOR I PERGJITHSHEM
SHERBIMI GJEOLOGJIK SHQIPTAR
RRUGA E KAVAJES NR.153

TIRANE

Lënda: Njoftim mbi fillimin e procedurave te revokimit te lejes nr. 1614 date 07.03.2013

I nderuar zoti Sulollari,

Shoqëria "O.L.I.A" sh.p.k është zotëruese e lejes minerare te kërkim - zbulimit nr.1614 date 07.03.2013, për mineral kromi, sipërfaqe 1.745 km², ne objektin "Ligata e Mërisë & Gjashtë lis, Rajcë, Bashkia Prrenjas, te Qarkut Elbasan..

Ne zbatim te pikave nr.2 e nr.3 te nenit 12 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar, shoqëria juaj ka aplikuar për shndërrimin ne leje shfrytëzimi te një pjese te zonës, qe ka pasur me leje kërkim - zbulimi, duke ndjekur procedurat e ligjore dhe është pajisur me leje shfrytëzimi nr.1614/1 date 25.04.2014 për një sipërfaqe 0.124km²

Për zonën e mbetur me leje kërkim - zbulimi, nga struktura përgjegjëse Shërbimi Gjeologjik Shqiptar ne mënyre te përsëritur dhe se fundi me shkresën nr. 1545 date 02.11.2015, protokolluar ne Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë me nr. 7189 date 03.11.2015 është propozuar revokimi i lejes nr.1614 date 07.03.2013, sepse nuk janë kryer pagesat e garancive financiare te programit minimal te punës dhe rehabilitimit te mjedisit ne përputhje me pikën 1 e pikën 2, te nenit 31 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar.

Propozimi i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar për revokimin e lejes nr.1614 date 07.03.2013, është i mbështetur ne ligjin nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin minerar ne Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, pasi ju keni shkelur germën "ç" te pikës 1 te nenit 47 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar, qe është shkelje ligjore për te cilën një leje revokohet.

Sa me sipër ne zbatim te nenit 48 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin minerar ne Republikën e Shqipërisë" te ndryshuar, **ju njoftojmë se ka filluar procedura e revokimit te lejes**